KOMUNIKATË PËR WEB

Statistika e Lindjeve, Vdekjeve, Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve, Mars 2024

15.05.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat preliminare[1] në baza mujore për Lindjet, Vdekjet, Kurorëzimet dhe Shkurorëzimet për muajin Mars 2024.

Këto të dhëna publikohen duke u bazuar në të dhëna administrative.

Sipas dispozitave ligjore mbi udhëheqjen e regjistrave themeltarë për Lindjet, Vdekjet, Kurorëzimet dhe Shkurorëzimet, rastet regjistrohen në mënyrë të obligueshme në regjistrat e lartë-cekur, në vendin ku ka ndodhur ngjarja, pa marrë parasysh se personat me të cilët lidhet ngjarja, vendbanimin e përhershëm e kanë në atë vend, ose në ndonjë vend tjetër.

Në muajin Mars 2024 janë regjistruar 2 042 lindje (brenda dhe jashtë Kosovës). Prej këtyre lindjeve të regjistruara 1 094 lindje janë meshkuj dhe 948 lindje janë femra.

Ndërsa, janë regjistruar gjithsej 876 raste të vdekjeve (brenda dhe jashtë Kosovës). Prej vdekjeve të regjistruara, 471 janë meshkuj dhe 405 janë femra.

Në muajin Mars 2024 janë regjistruar gjithsej 1 238 kurorëzime (brenda dhe jashtë Kosovës), kurse shkurorëzime të ndodhura në Kosovë janë regjistruar 149 raste.

ASK-ja do të vazhdojë me grumbullimin e të dhënave përmes pyetësorëve të veçantë statistikorë, për Lindjet DEM-1, Vdekjet DEM-2, Kurorëzimet DEM-3, dhe Shkurorëzimet SHK-1, sikurse deri më tani. Grumbullimi i të dhënave vazhdon të bëhet çdo muaj dhe do të shërbejë për krijimin e bazës së të dhënave, si dhe krahasimin me të dhënat administrative.

Burimi i të dhënave të këtij publikimi është Agjencia e Regjistrit Civil të Kosovës (ARC).

[1] Shfrytëzuesve të të dhënave u rekomandohet, që këto të dhëna të merren si të dhëna preliminare dhe jo si të dhëna përfundimtare.